



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Gjatë vitit 2022, Ministria kishte kryer një pagesë në vlerë prej 58,286€ në kategorinë jo adekuate ekonomike si rezultat i planifikimit jo të duhur të buxhetit për kontratën “Programi Kombëtar për inventarizimin e tokave bujqësore në Republikën e Kosovës – Servisimi dhe kalibrimi i pajisjeve laboratorike Loti 2”.
- C1 Vlera e pasurisë mbi 1,000€ ishte mbivlerësuar për 182,350€, për shkak të regjistrimit të pasurive të cilat nuk i plotësojnë kriteret për regjistrim si pasuri në SIMFK. Në anën tjetër, regjistri i pasurisë ishte nënvlerësuar pasi që ministria gjatë vitit 2022 kishte bërë identifikimin e 129 pronave tokësore të IBK-së, mirëpo nuk kishte arritur të bëjë një vlerësim financiar për pronat e identifikuara dhe t'i evidentoj/regjistrojë ato në regjistrat e pasurisë.
- A1 Projekti “Konsolidimi dhe inventarizimi i tokave bujqësore në Republikën e Kosovës” është regjistruar në kategorinë joadekuate të pasurisë duke rezultuar me zhvlerësim të pasaktë të pasurisë. Si rezultat i kësaj regjistri i pasurisë është nënvlerësuar për 715,538€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MBPZHR kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të aplikimit, kontrollit administrativ, kontrollit në terren, si dhe miratimit dhe ekzekutimit të pagesave deri tek përfituesi. AZHB që nga viti 2018 ka të formuar Drejtorinë e Financave, mirëpo edhe gjatë vitit 2022 ekzekutimi i pagesave për AZHB ka vazhduar të bëhet nga zyra qendrore e financave në Ministri.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të

brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat për përmirësim janë identifikuar tek pasuritë dhe te shpenzimet që ndërlidhet me klasifikim jo adekuat të shpenzimeve, në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, procesit të vlerësimit të ofertave dhe vonesën në aprovimin e Programit për zhvillim rural (grante).

Ky raport ka rezultuar me 8 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, tri (3) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Në një rast kemi vërejtur se pagesa në vlerë prej 58,286€ për kontratën "Programi Kombëtar për inventarizimin e tokave bujqësore në Republikën e Kosovës - Servisimi dhe kalibrimi i pajisjeve laboratorike Loti 2" ishte paguar nga kategoria e investimeve kapitale, përderisa për nga natyra i takon kategorisë së mallrave dhe shërbimeve sepse ka të bëjë me servisim dhe kalibrim të pajisjeve laboratorike të IBK-së.

Kjo kishte ndodhur për shkak se MBPZhR kishte planifikuar këtë kontratë në kategorinë jo adekuate të shpenzimeve.

Ndikimi Pagesa e kryer nga kategoria jo adekuate e shpenzimeve ka ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësim të kategorive përkatëse dhe për efekt kanë paraqitjen jo të saktë dhe të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të sigurojë planifikimin e buxhetit në përputhje me natyrën e projekteve në mënyrë që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregulltë të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mbivlerësim / nënvlerësim i pasurisë kapitale

Gjetja Neni 6 paragrafi 3 i rreg. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".

Vlera e pasurive kapitale në MBPZhR ishte mbivlerësuar për 182,350€, në anën tjetër ishte nënvlerësuar si rezultat i mos regjistrimit të pronave të identifikuara të IBK-së, për rastet si në vijim:

- Ministria kishte regjistruar si pasuri pesë (5) pagesa në vlerë totale prej 186,398€ që kanë të bëjnë me kontratën "Programi Kombëtar për inventarizimin e tokave bujqësore në Republikën e Kosovës – Servisimi dhe kalibrimi i pajisjeve laboratorike Llot 2". Kjo kontratë ka të bëjë me servisim, kalibrim dhe ndërrim të pjesëve të pajisjeve të cilat nuk i plotësojnë kriteret për regjistrim si pasuri mbi 1,000€ në SIMFK.

Në regjistrin e pasurisë katër nga këto pagesa figurojnë si investim në vijim, ndërsa pagesa në vlerë 58,286€ ishte regjistruar si pasuri në përdorim dhe ishte zhvlerësuar për 4,048€. Si rezultat, regjistri i pasurisë ishte mbivlerësuar për 182,350€; dhe

- Ministria nuk i ka të evidentuara në regjistrin e saj të pasurive të gjitha pronat tokësore të IBK-së. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e pronave të paluajtshme të IBK-së i formuar nga Sekretari i Përgjithshëm (SP), më datë 27.10.2022 kishte përpiluar një raport në bazë të dhënave kadastrale dhe vizitave në teren ku sipas këtij raporti pronat e IBK-së janë të vendosura në tri Komuna: 1. Prishtinë - 15 parcela me sipërfaqe prej 141,997 m²; 2. Pejë - 113 parcela të shpërndara në katër zona kadastrale (Pejë, Vitomericë, Bllagajë dhe Joshenicë) me sipërfaqe të përgjithshme prej 2,838,964 m²; dhe 3. Prizren - një parcelë me sipërfaqe prej 2,140 m². Për këto prona, ministria nuk kishte arritur të bëjë një vlerësim financiar dhe si rrjedhojë nuk i ka të regjistruara në regjistrat e pasurive, duke e nënvlerësuar regjistrin e pasurisë. Më datë 27.02.2023 është formuar Ekipi punues nga SP për hartimin e projekt rregullores për caktimin e metodave të vlerësimit të pronave të Ministrisë i cili gjatë kohës sa ne kemi qenë në auditim ishte ende në proces të punës.

Pamundësia e regjistrimit të pronave në regjistrat e pasurisë kishte ndodhur për shkak të kompleksitetit të procesit të identifikimit të pronave në njërën anë, ku disa prona ishin identifikuar si të tjetërsuara/uzurpuara të cilat janë në emër të IBK-së, ndërsa në anën tjetër për shkak të kohës së kufizuar për vlerësimin financiar të tyre dhe inkorporimin e shënimeve në Pasqyra financiare. MBPZhR kishte kërkuar edhe mendim profesional nga Departmenti i Tatimit në pronë dhe zyra e vlerësimit të pronës së paluajtshme në kuadër të MFPT, por të njëjtit nuk kishin mundur të kryejnë vlerësimin e pronave, me arsyen se merren vetëm me shpronësimin e tyre. Ndërsa, mbivlerësimi i pasurisë kishte ndodhur për shkak të planifikimit të gabuar të buxhetit për këtë projekt dhe mungesës së njohurive adekuate rreth klasifikimit të pasurive nga zyrtari i pasurisë. Vlen të theksohet se ministria më datë 07.04.2023 kishte bërë kërkesë në Thesar për largimin e këtyre pasurive nga SIMFK.

Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha pronave të MBPZhR dhe regjistrimi i gabuar i pasurisë ka ndikuar në nënvlerësimin/mbivlerësimin e pasurisë në regjistrat kontabël dhe njëherit ka rezultuar në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PVF.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të sigurojë se për pronat e identifikuar të bëhet vlerësim financiar dhe të njëjtat të regjistrohen në regjistrin e pasurisë. Po ashtu, duhet të sigurojë se zyrtari i pasurisë të regjistrojë vetëm pasuritë të cilat i plotësojnë kriteret për regjistrim, në mënyrë që të mundësohet regjistër i saktë i pasurisë dhe raportim i drejtë në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Gabim në përlogaritjen e shpenzimeve të zhvlerësimit

Gjetja Sipas nenit 22, paragrafi 4 të rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcaktohen normat e përgjithshme të zhvlerësimit bazuar në natyrën e pasurisë.

Projekti “Konsolidimi dhe inventarizimi i tokave bujqësore në Republikën e Kosovës”, IBK, me vlerë 1,491,490€ ishte kategorizuar si ‘Pajisje të teknologjisë informative’ me jetëgjatësi 3 vite, sipas rregullores do të duhej të ishte kategorizuar si 10 vite. Vlera neto në libra (VNL) në fund të vitit 2022 për këtë pasuri ishte 469,292€, përdërisa vlera e saktë do të duhej të ishte 1,184,830€. Si rezultat i këtij gabimi në kategorizim të pasurisë, regjistri i pasurisë ishte nënvlerësuar për 715,538€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kategorizimit të gabuar me rastin e blerjes së këtyre pasurive nga zyrtari i pasurisë.

Ndikimi Klasifikimi jo i duhur i projektit në regjistrat kontabël ka ndikuar në aplikimin e pasaktë të normave të zhvlerësimit dhe ka shkaktuar një nënvlerësim të vlerës së pasurisë në regjistrat kontabël. E gjithë kjo ka rezultuar në pasqyrim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PVF.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurojë se janë bërë rregullimet e nevojshme në normën e zhvlerësimit për projektin në fjalë, duke siguruar që regjistri i pasurive të jetë i kategorizuar drejtë në mënyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofrojë informata të sakta dhe të drejta në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime (me shpenzime komunale) në vitin 2022 ishte 3,157,735€, prej tyre ishin shpenzuar 2,460,467€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime të qirasë, furnizime me material shpenzues, mirëmbajtje, shërbime kontraktuese, etj.

Çështja A2 - Mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave

Gjetja Sipas dosjes së tenderit për shërbime të veçanta tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit, pika 19.1 Vlerësimi i propozimeve teknike - ishte vendosur si kriter që Nota teknike minimale (Nt) që kërkohet për të kaluar pragun nga ofertuesit ishte 50 pikë nga 100 pikë të mundshme.

Në dosjen e tenderit tek procedura e prokurimit “Shërbime konsulente nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta, (konsulent individ) inspektor teknik për nevojat e AZHB-së”, është kërkuar që nota teknike minimale (Nt) për të kaluar është 50 pike nga 100 pikë të mundshme.

Nga 22 ofertues, 14 prej tyre ishin kontraktuar nga ministria edhe pse nuk kishin kaluar pragun prej 50 pikëve të kërkuara.

Kjo kishte ndodhur për shkak se komisioni i vlerësimit të tenderit kishte mbledhur gabimisht pikët e vlerësimit teknik me pikët e vlerësimit financiar, edhe pse kriteri ishte që të arrihet nota teknike minimale për të kaluar tek vlerësimi financiar.

Ndikimi Gabimet në përlogaritje në procesin e vlerësimit nga ana e komisionit, kanë ndikuar që të rekomandohen inspektor teknik për kontratë të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret për dhënie të kontratës.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësit e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 76,061,692€, prej tyre ishin shpenzuar 70,262,986€. Kategoria e subvencioneve dhe transfereve përbën 91% të shpenzimeve të përgjithshme të Ministrisë, që kanë të bëjnë kryesisht me pagesat direkte, grantet dhe dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi. Zbatimi i këtyre programeve bëhet në baza vjetore sipas Programit për Zhvillim Rural dhe Programit për Pagesa Direkte. Hartimi i këtyre politikave bëhet nga departamenti për Zhvillimin e Politikave Bujqësore dhe Tregjeve, si dhe nga Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural. Implementimi i tyre bëhet nga AZHB-ja, ndërsa pagesa e tyre realizohet nga departamenti i financave të Ministrisë.

Çështja A3 - Vonesë në aprovimin e Programit për Zhvillim Rural

Gjetja Programi për Zhvillim Rural është i bazuar në Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, dhe në Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Kështu, programi i mbështetjes financiare duhet të jetë në përputhje me ndarjet buxhetore të vitit.

Ministria, Programin për Zhvillim Rural (PZHR) për vitin 2022 e kishte aprovuar me datë 10.06.2022. Si rezultat i kësaj vonese projektet nuk kanë mundur të kontraktohen, realizohen dhe të paguhen deri në fund të vitit (masat e subvencionimit afatin e implementimit e kanë nga 90 ditë deri në 10 muaj varësisht nga specifikat, me një zgjatje të mundshme të afateve prej 30-60 ditë nëse ka arsye të qëndrueshme), marrë parasysh që njëkohësisht janë të përcaktuar hapat dhe afatet kohore të: thirrjes për aplikim, kontrollit administrativ të aplikacioneve, kontrolleve në terren, poentimit, kontraktimit dhe kërkesave për pagesë nga përfituesi (15 ditë).

Sa i përket zbatimit të PZHR për 2022, 4,148,593€ janë paguar në emër të pjesës së parë të grantit tek përfituesit deri në dhjetor të 2022.

Vonesa në aprovimin e PZHR kishte ndodhur për shkak të mos ndërmarrjes së veprimeve të duhura për hartimin dhe miratimin e këtij programi në harmoni me ciklin buxhetor.

Ndikimi Shpallja e programit në këtë periudhë të vitit mund të shkaktoj obligime kontraktuale të bartura për pagesë për vitin në vijim të cilat rëndojnë bilancin e obligimeve për ministrinë, si dhe e rrezikojnë realizimin e objektivave vjetore të mbështetjes financiare të përcaktuara për vitin pasues.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të siguroj se programi për zhvillim rural aprovohet pas miratimit të Ligjit të buxhetit vjetor me qëllim të harmonizimit të tij

me ciklin buxhetor, thirrjen për ndarjet vjetore të granteve si dhe ekzekutimin e pagesave brenda vitit të jenë në përputhje me buxhetin e aprovuar vjetor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në Raportin vjetor financiar për vitin 2022 e pasurive kapitale është 41,974,493€, pasurive jokapitale është 244,681€, si dhe e stoqeve 14,725€.

Çështja B2 - Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë dhe mos largimi i pasurisë jashtë përdorimit nga regjistri

Gjetja

Neni 19 paragrafi 4.3 i rregullores Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se: Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe “Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare”.

Ministria kishte formuar komisionet për kryerjen e inventarizimit të pasurisë për vitin 2022. Këto komisione kanë përgatitur raporte gjithëpërfshirëse, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe raportimi i pasurive në PVF ishte bërë sipas regjistrave kontabël.

Si rezultat i mos-harmonizimit të regjistrat të pasurisë me shënimet e komisionit të inventarizimit, vetura e identifikuar në raportin e auditimit të vitit të kaluar me vlerë të mbetur prej 6,533€ e cila është jashtë funksionit (e prishur), ende figuron në regjistrat e pasurisë si pasuri në përdorim, e njëjta nuk ishte përfshirë në raportin e tjetërsimit të pasurisë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të strukturës së shpërndarë organizative si dhe kontrolleve të brendshme jo adekuate.

Ndikimi

Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë dhe mos përfshirja e veturës në raportin e tjetërsimit reflekton në mbi/nënvlerësimin e gjendjes së pasurisë.

Rekomandimi B2

Ministri duhet të sigurojë që komisionet përkatëse pas përfundimit të raportit të inventarizimit të bëjnë harmonizimin me gjendjen në regjistrat e pasurisë, para përgatitjes së PFV-ve, me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen e saktë të pasurive me të cilat disponon ministria. Po ashtu, pasuria jashtë përdorimit të përfshihet në raportet e tjetërsimit dhe e njëjta të largohet nga regjistri i pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Të arkëtueshmet

MBPZHR në raportin vjetor financiar të vitit 2022 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,656,186€. Kjo vlerë ka të bëjë me operatorët që janë paditur për shfrytëzimin e pronës publike, të hyra të pa inkasuara për dhënien e tokës pyjore dhe tokës bujqësore me qira, licenca për laborator, etj.

Çështja B3 - Vonesë në vazhdimin e kontratës për pronën e lëshuar me qira dhe mos inkasim i të hyrave nga qiraja

Gjetja Sipas nenit 3.4 të kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë dhe qiramarrësve për shfrytëzimin e pronave – qiramarrësi obligohet që kompensimin e mjeteve financiare ta bëjë deri më datën 10 të çdo muaji vijues. Po ashtu, sipas nenit 6 - qiradhënësi mund ta ndërpres kontratën për qiranë në rast se qiramarrësi nuk e paguan qiranë.

Në një rast kemi vërejtur se shfrytëzuesi i pronës nuk kishte kryer obligimet në vlerë prej 11,650€. Ministria kishte formuar Komisionin punues për vlerësimin e pronave të paluajtshme i cili kishte për detyrë shqyrtimin e kërkesave dhe verifikimin e gjendjes së pronave për vazhdimin e kontratave të pronave nën menaxhimin e IBK-së në Zonën Industriale Magjistranja Prishtinë-Fushë Kosovë. Me datë 25.03.2022 ky komision ka përfunduar raportin përkatës në të cilin është bërë vërtetimi i gjendjes faktike dhe përshkrimi i gjendjes së parcelave. Përkundër këtij raporti dhe informatave që kontrata skadon më 31.05.2022, deri më 21.12.2022 SP nuk kishte marrë vendim për caktimin e Komisionit për shqyrtimin e vazhimit të kontratave.

Kjo pronë ishte shfrytëzuar nga qiramarrësi i njëjtë pa kontratë me ministrinë, derisa me rekomandim të komisionit përkatës nga 03.02.2023, të njëjtit i ishte vazhduar kontrata. Sipas kontratës së re qiramarrësi obligohet që brenda 15 dite pas nënshkrimit të kontratës ta kompensoi borxhin e akumuluar (mbetur) nga data 01 qershor 2022 deri më 31 dhjetor 2022 në shumën e përgjithshme prej 9,050€. Edhe përkundër kësaj, kjo shumë dhe borxhi i kontratës paraprake prej 2,600€ ende nuk ishin paguar nga qiramarrësi.

Vonesa në vazhdimin e kontratës ka ndodh si rezultat i mungesës së vlerësimit financiar të pronave të ministrisë. Ndërkohë që nga ministria nuk ishin ndërmarrë veprime të mjaftueshme për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi Mungesa e veprimeve konkrete për arkëtimin e të arkëtueshmeve rrezikon me humbje financiare për Ministrinë dhe mund të shkaktojnë precedent duke ndikuar negativisht në subjektet tjera që ti paguajnë obligimet e tyre me kohë, ndërsa vjetërsia e tyre e vështirëson inkasimin. Vonesa në vazhdimin e kontratave për qiradhënie dhe

shfrytëzimi i pronës nga qiramarrësi pa kontratë rrit rrezikun që prona të shfrytëzohet për qëllime tjera nga kushtet dhe mënyrat e përcaktuara me kontratë.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të siguroj efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke ndërmarrë të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga dhënia me qira të tokave bujqësore. Po ashtu, duhet të sigurohet se janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe në kohë që pronat e Ministrisë nuk shfrytëzohen pa kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në MBPZHR operon me tre anëtarë të stafit (Zv. Drejtor i NjAB-së dhe dy auditorë). Për vitin 2022, kjo njësi kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik ku kishte planifikuar nëntë (9) auditime (shtatë të rregullta dhe dy me kërkesë), prej të cilave kishte finalizuar shtatë auditime të rregullta dhe një me kërkesë të Menaxhmentit. Periudha e mbuluar në raportet e NjAB kryesisht përfshinte vitin e kaluar deri në kohën e përfundimit të auditimit përkatës. Po ashtu, në kuadër të MBPZHR operojnë edhe dy Njësi të veçanta të Auditimit të Brendshëm, në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe në Agjencinë e Pyjeve të Kosovës (APK). Për vitin 2022, NjAB në APK kishte planifikuar dhe realizuar tri auditime. Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2022 kishte mbajtur katër takime duke shqyrtuar aktivitetet dhe realizimin e planit vjetor të NjAB të MBPZHR, APK dhe AZHB-së.

Çështja A4 - Mos aprovimi më kohë dhe mos realizimi i planit vjetor të auditimit në AZHB

Gjetja

Sipas Rregullores QRK-nr 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik te neni 10, pika 1.2 përcaktohet se Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm dhe i dorëzon në Njësinë Qendrore Harmonizuese, më së largu deri më 31 dhjetor të vitit fiskal. Sipas planit vjetor të punës për vitin 2022, NJAB kishte planifikuar të kryej pesë (5) auditime.

Plani vjetor i auditimit të AZHB është aprovuar me 25.02.2022 nga Ministri, me vonesë për afërsisht dy muaj. Në vitin 2022, NjAB e AZHB-së nga pesë auditimet e planifikuara nuk kishte finalizuar asnjë. Përderisa, një auditim i rregullt dhe një me kërkesë të ministrit që ishin të përfshira në planin e auditimit për vitin 2022, janë finalizuar me datë 16.02.2023.

Mos finalizimi i raporteve është konfirmuar edhe nga Komiteti i Auditimit në takimin e mbajtur me 27.12.2022.

Mos kryerja e auditimeve sipas planit ishte si pasojë e vonesës së aprovimit të planit vjetor si dhe pakujdesisë/neglizhencës së zyrtarëve të auditimit të AZHB.

Ndikimi

Mos përmbushja e planit të auditimit mund të rezultojë në mungesë të zbatimit të kontrolleve të brendshme dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.

Rekomandimi A4

Ministri duhet të sigurojë se plani vjetor i auditimit aprovohet me kohë si dhe auditimet kryhen sipas planit të aprovuar, me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	71,097,911	84,801,949	77,257,371	74,998,863	69,734,309
Grante Qeveritare – Buxheti	66,348,574	79,902,549	74,545,887	71,157,826	64,104,081
Financimi përmes huamarrjes	2,605,413	2,605,413	1,126,009	1,917,705	4,073,675
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	1,960,769	1,960,769	1,526,931	1,777,899	1,414,197
Të bartura nga viti i kaluar	0	150,063	58,544	112,342	72,768
Të hyrat vetanake	183,155	183,155	0	33,092	69,589

Buxheti final i MBPZhR është më i lartë se buxheti fillestar për 13,704,038€. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 13,553,975€ dhe përfshirjes së të hyrave të bartura prej 150,063€ në buxhet final.

Në vitin 2022, MBPZhR ka shpenzuar 91% të buxhetit final ose 77,257,371€, me një ulje prej 5% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	71,097,911	84,801,949	77,257,371	74,998,863	69,734,309
Pagat dhe mëditjet	3,045,778	3,045,778	2,458,724	2,468,689	2,595,904
Mallrat dhe shërbimet	3,128,682	3,022,075	2,404,100	2,096,169	3,325,787
Komunalitë	135,660	135,660	56,367	72,956	61,003
Subvencionet dhe transferet	58,577,022	76,061,692	70,262,987	67,989,985	61,643,007

Investimet Kapitale	6,210,769	2,536,744	2,075,193	2,371,064	2,108,609
---------------------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------

MBPZHR kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti fillestar dhe ai final për paga dhe mëditje nuk kishte ndryshime, ndërsa shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 81% e buxhetit. Kjo gjendje ishte ndikuar nga mos plotësimi i pozitave të parapara në Ligj të Buxhetit;

- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 106,606€. Kjo ishte si rezultat i të hyrave vetanake të bartura prej 150,063€, kursimeve të buxhetit me Vendime të Qeverisë (nr. 11/112 dhe 01/117) prej 842,000€ dhe transfereve të brendshme nga subvencionet dhe transferet prej 515,330€ si dhe transferit nga investimet kapitale prej 70,000€. Ndarja e mjeteve nga Qeveria ishte bërë me kërkesë të Ministrisë për rekrutimin e inspektorëve përmes Marrëveshjeve për shërbime të veçantë dhe bartjes së mjeteve nga fondi 04 në programin DFSHP. Ekzekutimi i buxhetit tek kjo kategori është 80%. Buxheti nuk ishte realizuar në plotësi për shkak të mos realizimit të projekteve të avancimit dhe sistemit informativ të shërbimeve të këshillëdhënëse si dhe konsolidimit të tokave;


- Buxheti fillestar dhe ai final për shpenzime komunale nuk kishte ndryshime, ndërsa për periudhën janar-dhjetor 2022 ekzekutimi i buxhetit është vetëm 42%. Kjo për shkak se DFSHP së bashku me zyrat regjionale të AZHB-së kishin më pak shpenzime komunale;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 17,484,670€. Kjo ishte si rezultat i transfereve të brendshme në kategorinë e mallra dhe shërbimeve në vlerë prej 515,330€ dhe ndarjes së mjeteve me vendim të Qeverisë (nr.24/96) lidhur me pakon e Ringjalljes ekonomike në vlerë prej 18,000,000€. Shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 92% e buxhetit. Pjesa e pashpenzuar e buxhetit ka të bëjë me aprovimin e vonshëm të Programit për zhvillim rural i cili ka ndikuar që projektet e granteve të barten për pagesë në vitin vijues; dhe

- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 3,674,025€. Kjo ishte si rezultat i kursimeve buxhetore nga MFTP në vlerë prej 3,604,025€ dhe transfereve të brendshme tek mallrat dhe shërbimet prej 70,000€. Përkundër zvogëlimit të buxhetit të projekteve, MBPZHR nuk kishte mundur të realizonte më shumë se 82% të buxhetit për investime kapitale. Vlen të theksohet se në MBPZHR në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022 nuk ishte iniciuar asnjë procedurë e prokurimit, për shkak se nuk janë bërë kërkesat për inicim nga njësitë kërkuese. Mos realizimi i buxhetit te kjo kategori ishte i reflektuar edhe për shkak të anulimeve të procedurave të prokurimit, mos aprovimit të procedurave të prokurimit për IBK, kontraktimit të projektit në nëntor të vitit 2022 për projektin “Ndërtimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujitjës në Kosovë” si projekt me vlerë më të madhe (1,514,508€) e që pagesat kanë mbetur të paguhen në vitin vijues.

Buxheti i ndarë për zbatimin e programit për rimëkëmbje ekonomike për vitin 2022 është 18,000,000€, ndërsa shpenzimet ishin 17,991,508€. Ato kanë të bëjnë me mjetet e ndara nga Qeveria për zbatimin e programit për rimëkëmbje ekonomike në kuadër të masës 2.5 – Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga MBPZHR në 2022 ishin në vlerë 2,570,437€. Krahasuar me vitin e kaluar kishte ulje të inkasimit të të hyrave për 109,626€ apo 4%. Të hyrat realizohen nga lëshimi i licencave, të hyrat nga qiraja e tokës së dhënë në shfrytëzim, shitja e shërbimeve, etj. Shuma prej 2,191,660€ apo 85% e të hyrave e të hyrave totale janë realizuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës (APK), ndërsa pjesa tjetër është realizuar nga departamentet tjera. Shuma prej 69,969€ ka të bëjë me kthimin e mjeteve nga viti i kaluar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	2,976,915	2,976,915	2,570,437	2,680,063	2,364,281
Të hyrat jo tatimore	2,976,915	2,976,915	2,500,467	2,664,098	2,235,803
Të hyrat tjera	0	0	69,970	15,966	128,477

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka rezultuar në 11 rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Ministria për vitin 2022 po ashtu kishte përgatitur një raport periodik për progresin në zbatimin e rekomandimeve ku janë paraqitur veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, shtatë (7) rekomandime janë adresuar, tri (3) rekomandime nuk janë adresuar, ndërsa një (1) rekomandim është adresuar pjesërisht.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë e gjetjeve që kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të auditimit dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që mangësitë dhe gabimet e tilla të mos përsëriten gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2022. Pasqyrat financiare të mos dorëzohen në Thesar-MFPT para se t'i	Është adresuar rekomandimi lidhur me shpalosjet në PFV në Raportin e Detyrimeve të papaguara, Detyrimet kontigjente, Pasuritë jo	I zbatuar

		nënshtrohen një rishikimi të detajuar nga ana e menaxhmentit.	kapitale me vlerë nën 1,000€ dhe Raporti për të hyrat vetjake të pashpenzuara pasi ato përmbanin informata të sakta dhe të drejta.	
2.	Baza për konkluzion	Ministri përmes zyrës së financave dhe drejtorive përkatëse duhet të forcojnë masat e përgjegjësisë ndaj zyrtarëve financiar dhe zyrtarëve tjerë administrativ për të siguruar se të gjitha obligimet do të paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave, ndërsa tek subvencionet dhe transferet duhet të ndërmerren veprime për zbatimin në praktikë të afatit kohor nga kërkesa deri te finalizimi i pagesës duke e eliminuar tejkalimin e afatit për pagesë.	Gjatë auditimit nuk kemi hasur në vonesa në ekzekutimin e pagesave.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se ky projekt vihet në funksion si dhe regjistrohet në regjistrat përkatës të pasurisë. Po ashtu, të sigurojë se Komisioni i formuar për shqyrtimin dhe vlerësimin e pronave të IBK-së do të finalizojë evidentimin e pasurive dhe të njëjtat të regjistrohen në regjistrat e pasurisë.	Ministria kishte regjistruar projektin “Konsolidimi dhe inventarizimi i tokave bujqësore në Republikën e Kosovës” në regjistrat e pasurisë. Ndërsa, sa i përket pronave të IBK-së, Ministria kishte bërë identifikimin e tyre, mirëpo nuk kishte arritur që të bëjë vlerësimin financiar dhe evidentimin e tyre në regjistrat e pasurisë. Shih Çështjen C1.	Pjesërisht i zbatuar

4.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë planifikimin e buxhetit në përputhje me natyrën e projekteve në mënyrë që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestnimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregulltë të shpenzimeve.	Edhe këtë vit kemi hasur në keqklasifikim të shpenzimeve. Shih çështjen B1.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që të gjitha raportet e kontrolles Ex-post të përcillen me veprime konkrete në kohën e paraparë për monitorimin e tyre. Në rastet e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga përfituesit, të ndërmerren masat për pezullimin dhe kthimin e mjeteve siç kërkohet me marrëveshje.	Nga kontrollet e realizuara ex-post në vitin 2022 për përfituesit e granteve të vitit 2019, Ministria ka ndërmarrë hapa për përjashtimin të përfituesit nga programet përkrahëse dhe iniciimin e procedurave gjyqësore, aty ku janë identifikuar mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale nga përfituesit.	I zbatuar
6.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e mbipagesave me rastin e kompenzimit të dëmeve për fermerët si dhe ta konsultoj zyrën ligjore dhe Komunën përkatëse duke u angazhuar në kthimin e këtyre pagesave nga përfituesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu, duhet të siguroj krijimin e bazës ligjore në të cilën do të vendosen kritere të qarta të aplikimit dhe vlerësimit të dëmeve duke forcuar kontrollet para realizimit të shpenzimeve.	Ministria kishte krijuar Udhëzues për vlerësimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në bujqësi i cili përcakton mënyrën, formën e kompenzimit të dëmeve, aktivitetet e kontrollit të mbikëqyries së	I zbatuar

			eliminimit të parregullsive dhe hartimin e çmimeve të kulturave. Gjatë auditimit të këtij viti përmes mostrave nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi. Përfituesit e evidentuar në raportin e vitit të kaluar kishin kthyer mjetet në llogarinë e buxhetit, ndërsa ndaj njërit përfitues ishin iniciuar procedura gjyqësore.	
7.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë azhurnimin e çmimore në bazë të së cilës miratohen çmimet e granteve duke bërë hulumtimin e tregut për masat përkatëse, në mënyrë që ajo të jetë më gjithëpërfshirëse dhe të mundësojë trajtim të barabartë të kërkesave nga përfituesit.	Nga testimi i projekteve të zhvillimit rural kemi vërejtur se të gjitha çmimet e granteve ishin bazuar në Listën e pranueshme sipas çmimore 2022.	I zbatuar
8.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë që të ndërmerren masat/veprimet konkrete për të siguruar që garancionet bankare të ofruara nga përfituesit për paradhënjen prej 50% të përkahjes publike mbulojnë periudhën deri tek vendimi përfundimtar për pagesë apo refuzim të pagesës përfundimtare, me qëllim të marrjes së sigurisë dhe evitimit të procedurave gjyqësore me rastin e mos përmbushjes së projekteve nga përfituesit.	Nga auditimi i granteve nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
9.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë që komisionet për invertarizimin dhe vlerësimin e pasurisë të përfundojnë punën e tyre para përgatitjes së pasqyrave financiare, si dhe të bëjnë	Gjatë auditimit edhe këtë vit kemi hasur në mungesën e harmonizimit të	Nuk ka filluar zbatimin

		krahasimin e të dhënave si rezultat i inventarizimit me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël. Mungesat, tepricat, pasuritë e dëmtuara, duhet t'i prezantojë në raport dhe të njëjtin duhet ta aprovoj menaxhmenti në mënyrë që ndryshimet të reflektohen edhe në regjistrat kontabël.	raportit të inventarizimit të pasurisë me regjistrat të pasurisë dhe mos largim të pasurisë jashtë përdorimit nga regjistrat e pasurisë. Ndërsa, komisionet përkatëse të vlerësimit kishin përfunduar raportet e tyre me kohë. Shih Çështjen B2.	
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të siguroj efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke ndërmarrë të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga dhënia me qira të tokave bujqësore.	Gjatë auditimit të llogarive të arkëtueshme edhe këtë vit kemi hasur në një rast ku nuk është bërë kryerja e obligimeve sipas kontratës nga operatori dhe Ministria nuk kishte ndërmarrë veprime për inkasimin e borxhit. Për më tepër, Ministria kishte vazhduar me vonesë kontratën me qiramarrësin duke ndikuar që operatori të shfrytëzoj hapësirën pa kontratë. Shih çështjen B3.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të sigurojë se roli, puna dhe misioni i KA në Ministri po përmbushet dhe funksioni i auditimit të brendshëm është i monitoruar mirë me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës.	Komisioni i auditimit ka shqyrtuar punën e NjAB të AZHB-së dhe APK-së.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Nora Rashiti, Udhëheqëse e ekipit



Astrit Bllaca, Anëtar i ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Faton PEÇI

Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Data: 19.Qershor.2023, Prishtinë.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.